




Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri


Duke u bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **26 korrik 2018**, mori këtë:


VENDIM
PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË NË KOMUNËN
E VUSHTRRISË PËR VITIN 2018

- 1.Me këtë vendim aprovohet Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018.
- 2.Qëllimi i aprovimit të këtij plani është konsolidimi i infrastrukturës juridike me qëllim të rritjes së transparencës dhe avancimin e efektivitetit në aktivitetin dhe veprimtarinë e Komunës së Vushtrrisë.
- 3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Zyra e komunikimit me publikun dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
- 4.Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin “Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018”.
- 5.Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri


Në bazë të nenit 12.2 pika „d” lidhur me nenin 17 pika „o” të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 7 dhe 13 të Ligjit për Sistemin e Adresave Nr.04/L-071, nenit 6 paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2012 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë dhe vendosjen e tyre nga regjistri komunal i adresave, si dhe nenin 40.2 pika „h” dhe 41.2 pika „ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë Nr.58/11 i dt.28/04/2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **26 korrik 2018** mori këtë:

VENDIM

PËR EMËRTIMIN E SHESHIT “AHMET KRASNIQI” NË VUSHTRRI

1. Me këtë vendim aprovet emërtimi i Sheshit „Ahmet Krasniqi” pranë objektit të ri të Komunës në Vushtrri.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikatat mbi të drejtën e pronës, kopjet e planit dhe projekti ideor lidhur me ndërtimin e këtij sheshi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPSTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	214/18
Nr. i fq. / Br. sh	- 2 -
Data: / Datum	26. 07. 2018
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 10.5 pika a dhe b, nenit 13.1, nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Tokën Bujqësore (Nr.02/L -26), nenit 6.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, nenit 12.2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 41.2 pika „ç“ të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **26 korrik 2018** mori këtë:

V E N D I M

PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për Arben Krasniqin në parcelën kadastrale me Nr.P-70202010-00130-1 me kulturë arë e klasës së 4 (katër), ZK-Bukosh me sipërfaqe prej 485.92 m² (katërqind e tetëdhjetë e pesë, e nëntëdhjetë e dy metra katrorë) e cila sipërfaqe kërkohet për shndërrim nga sipërfaqja e përgjithshme e P-70202010-00130-1 që është 3089m² dhe e cila është evidentuar në Certifikatën mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme Nr. i lëndës 18-1007-18 në emrin e Halit (Sinan) Krasniqi, babai i Arben Krasniqit ZK-Bukosh.
2. Qëllimi i lejimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore është **ndërtimi i objektit për banim individual – shtëpi në vendin e quajtur „Licanski Breg/Golo Brdo“** në parcelën kadastrale të cekur si në pikën një të këtij vendimi.
3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të cekur në pikën e dytë të këtij vendimi do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.
4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 pika „a“ të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr. 41/2006 përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikatat e pronësisë, kopja e planit, pëlqimi i dhënë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit


7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 nën “d” të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 41.2 nën “ç” të Statutit të Komunës dhe nenin 7 të Rregullores për Dhënie e Dekorativë 01 nr. 186/13, datë 15.7.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **26 korrik 2018**, mori këtë:

VENDIM PËR NDARJE TË DEKORATËS

- 1.Enver Zymberi** (post mortum) i ndahet çmimi “Hasan Prishtina” në rastin e mbajtjes së manifestimit “Ditët e Hasan Prishtinës”, në muajin gusht 2018.
- Autorizohet Kryetari i Komunës që në ditën e mbajtjes së këtij manifestimi të ia dorëzojë këtë çmim – dekoratë, familjarit të të ndjerit.
- Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.
- Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRA	
01 Nr. / Br	216/18
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	26.07.2018
VUSHTRRI - VUČITRA	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri


Duke u bazuar në nenin 12.2 pika "d" në lidhje me nenin 28 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 "ç" në lidhje me nenin 40.1 pika "i" të Statutit të Komunës. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më, **26 korrik 2018**, mori këtë:

VENDIM PËR APROVIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

1. Me këtë vendim aprovohet memorandumi i mirëkuptimit mes Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Skenderajt, Mitrovicës, Drenasit dhe Obiliqit.
2. Qëllimi i këtij memorandumi të mirëkuptimit është që pasuria natyrore e Bjeshkëve të Çyçavicës, e cila shtrihet në territorin e pesë (5) komunave të përfshira në këtë memorandum të mirëkuptimit, të shpallet zonë me interes të përgjithshëm.
3. Autorizohet Kryetari i komunës që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit, si dhe t'i marrë përsipër obligimet që burojnë nga ky dokument me qëllim të implementimit të këtij memorandumi të mirëkuptimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës


Kuvendi i Komunës-Vushtri

Duke u bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më **26 korrik 2018**, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NGA FONDI PËR SUBVENCIONE DHE
TRANSFERE

1. Me këtë vendim i ndahen mjete financiare në shumën prej dy mijë euro (2000 €), Ejonë Hasanit, nxënëse në gjimnazin „Eqrem Çabej” në Vushtri” e cila do të marrë pjesë në programin e këmbimit të nxënësve Kosovë-SHBA.
2. Programi do të mbahet në „Providence Academy” në Lilburn GA të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku nisja do të bëhet më datë 7 Tetor 2018, kurse kthimi më datë 4 nëntor 2018.
3. Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të ndahet nga kategoria subvencione dhe transfere me kod ekonomik 21200 subvencione për etnitete jopublike nga Drejtoria e Arsimit.
4. Pagesa e mjeteve financiare do të bëhet në emër të Bashkim Hasnit , (babai i Ejonë Hasanit).
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu


Kryesues i Kuvendit

